



UNIVERSITETI PRIZREN "UKSHIN HOTI"	
Pranuar ipe dt.	21.03.2022
Zyra e pranimi	Nr. i protokolit
308	01-117

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 21.03.2022

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 1të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, të nenit 26 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, duke u bazuar në konkursin publik me nr. prot. 01-58, të datës 15.02.2022, Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, në mbledhjen e mbajtur më 14.03.2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj, zgjedhet rektor i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.
2. Mandati i rektorit do të jetë për periudhën e mbetur sipas Vendimit të Këshillit Drejtues me nr. prot. 01-57, të datës 15.05.2019.
3. Pranimi i detyrës së rektorit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, do të bëhet menjëherë.
4. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit e rektorit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, janë të përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, si dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.
5. Të ardhurat personale dhe beneficionet tjera janë të përcaktuara me rregullore të brendshme të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Arsyetim

Duke u bazuar në nenin 26 dhe 27 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 14.02.2022, mori vendim mbi shpalljen e konkursit publik për pozitën e rektorit të Universitetit për mandatin e mbetur, sipas vendimit të Këshillit Drejtues me nr. prot. 01-175, të datës 15.05.2019. Konkursi publik për pozitën e rektorit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, është shpallur më datë 15.02.2022, dhe i njëjti është publikuar në uebfaqen e Universitetit. Senati i Universitetit në mbështetje të nenit 27 paragrafi 4, të Statutit të

Universitetit e ka formuar Komisionin profesional për shqyrtimin e dokumentacionit dhe propozimin e listës së kandidatëve për rektor. Bazuar në raportin me nr. prot. 02-102, të datës 10.03.2022, të Komisionit profesional për shqyrtimin e dokumentacionit dhe propozimin e listës së kandidatëve për rektor të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Këshilli Drejtues, i ka ftuar në intervistë kandidatët të cilët i kanë plotësuar kriteret për pozitën e rektorit. Pas intervistimit të kandidatëve, Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, në mbledhjen e mbajtur më 14.03.2022, me 2/3 e votave, me votim të fshehtë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi lejohet e drejta e ankesës në përputhje me nenin 185 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja



Kryesues i Këshillit Drejtues

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Zv. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyrës ligjore;
- Të përmendurit;
- Arkivit.